



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3125/16 Prot.

Tiranë, më 20.11 2023

V E N D I M

Nr. 78 datë 20.11 2023

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR POZICIONET E PUNËS,  
NË ADMINISTRATË**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor IAL, në Republikën e Shqipërisë", neni 49 pika.1 gërma f, neni 67, pika 3; në Statutin e UST-së, kreu V, neni 50; në Rregulloren e UST-së, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 27 datë 21.05.2021 "Për miratimin e rregullores së rekrutimit të personelit administrativ, në Universitetin e Sporteve të Tiranës" në VKM nr. 305, datë 05.04.2017 "Për disa shtesa në Vendimin nr.142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" të ndryshuar, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 20.11.2023,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kriterëve për hapjen e procedurave të konkursit për dy (dy) pozicione pune, në strukturën e administratës, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, si më poshtë vijon:

- 1 (një) Drejtor në Drejtorin në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, pranë Universitetit të Sporteve të Tiranës.
- 1 Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve Financiare

**Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati janë:**

1. Diplomimi në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës;
2. Kandidati duhet të zotërojë diplomë në Ciklin e Parë (Bachelor) dhe Ciklin e Dytë (Master), ose Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DNID) mbështetur në VKM "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" (Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi);
3. Të jetë i aftë për punë;
4. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë;
5. Ndaj tij/saj të mos jenë marrë masa disiplinore në fuqi;

### **Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e vecanta si vijon:**

- a) Të ketë diplomë Bachelor dhe Master Shkencor ose DIND, në shkenca ekonomike profili financë ose kontabilitet (Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi).
- b) Të kete përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushën e menaxhimit, financës ose kontabilitetit
- c) Të njohë legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiarë
- d) Të njohë dhe të përdorë programet bazë të punës në kompjuter, sidomos programin e kontabilitetit dhe të ketë certifikimet perkatëse
- e) Të ketë aftësi të mira komunikimi, etike profesionale dhe të dijë të punojë në grup.

### **DOKUMENTACIONI**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant
2. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me standardet e legjislacionit shqiptar;
3. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave të noterizuar.
  - a. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
  - b. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlersimin e njohur në Shtetin Shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptarë.
4. Diploma, çertifikata të ndryshme të kualifikimeve dhe trajimieve (të noterizuar);
5. Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj e noterizuar.
6. Dëshmi penaliteti. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore ose dëshmi penaliteti e lëshuar nga e-albania;
7. Fotokopje e librezës së punës ose vërtetim nga institucioni ku ka punuar;
8. Referenca nga punëdhënësi të mëparshëm;
9. Çertifikatë e gjëndjes familjare
10. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
11. Raport mjeko ligjor, që vërteton gjëndjen shëndetsore i aftë për punë.

Të miratojë kriteret për hapjen e procedurave të konkursit për 1 (një) pozicion pune si “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Shërbimeve Financiare pranë Drejtorisë së së Financës dhe Buxhetit, janë si më poshtë:

**Kriteret e përgjithshme:**

1. Diplomimi në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës;
2. Kandidati duhet të zotërojë diplomë të ciklit të parë ose të dytë, mbështetur në VKM “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” (Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi);
3. Të jetë i aftë për punë;
4. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë;
5. Ndaj tij të mos ketë masa disiplinore në fuqi;

**Kriteret e veçanta:**

1. Të ketë diplomë Bachelor dhe Master Shkencor ose DIND, në shkencë ekonomike profli financë ose kontabilitet, (Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi).
  2. Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 3 vite në fushën e menaxhimit, financës ose kontabilitetit
  3. Të njohë legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiarë.
  4. Diploma, çertifikata të ndryshme të kualifikimeve dhe trajnimeve (të noterizuar)
  5. Të ketë aftësi të mira komunikimi, etike profesionale dhe të dijë të punojë në grup.
2. Ngarkohet për vazhdimin e procedurave të mëtejshme Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës, Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/prot.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek portali i transparencës universitare.

**KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**ARTUR COBANI**

